



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE

SEKTORI I PROKURIMEVE

NR____prot

DATA:____/____/2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data:03/04/2026

Drejtuar:Erudit Kalemi Kalemi-PF,me NIPT:L41306076P dhe Adresë:Tiranë,Pezë Helmes,pranë pikës së karburantit,

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit:REF-76107-02-13-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pemë dekorative”

Fondi limit: 2,483,333.33(dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) LEKË PA TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 14 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 09/03/2026.

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Data:17/03/2026 Numri:19.*

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Erdit Kalemi Kalemi-PF NIPT: L41306076P

Vlera:2,150,000(dy milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë)LEKË PA TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

2.KEJ Group sh.p.k NIPT: M41707006H

Vlera:936,500(nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) LEKË PA TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

3.SARK sh.p.k NIPT: K52531415H

Vlera: 2,080,000(dy milionë e tetëdhjetë mijë) LEKË PA TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

4.Skyline SC sh.p.k NIPT: M51624039U

Vlera: 1,065,900(një milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) LEKË PA TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

5.T&J Construction sh.p.k NIPT: M29718101T

Vlera: 1,910 000(një milionë e nëntëqind e dhjetë mijë) LEKË PA TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. KEJ Group sh.p.k

NIPT: M41707006H

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Operatori ekonomik skualifikohet për arsye se artikujt në ofertën ekonomike të paraqitur në SPE,nuk janë ato të kërkuara në preventiv.

2. SARK sh.p.k

NIPT: K52531415H

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Operatori ekonomik skualifikohet per arsye se nuk plotëson kriterin:

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara.

Furnizimet e ngjashme të paraqitura në SPE nga operatori ekonomik, nuk kanë lidhje me objektin e tenderit.Konkretisht,kontrata e paraqitur është e llojit punë me objekt rikonstruksion rruge.

3. Skyline SC sh.p.k

NIPT: M51624039U

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Operatori ekonomik skualifikohet për arsye se artikujt në ofertën ekonomike të paraqitur në SPE,nuk janë ato të kërkuara në preventiv.

4. T&J Construction sh.p.k

NIPT: M29718101T

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Operatori ekonomik skualifikohet për arsye se nuk plotëson kriterin:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë(në lidhje me objektin e tenderit).
- Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikata ISO e paraqitur nga operatori ekonomik nuk përfshin objektin e tenderit.

-Nuk plotëson kriterin **3.1.** “Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, duhet të paraqesë:

-Kontratë furnizimi me një subjekt të licencuar për prodhim dhe/ose tregtim të materialit mbjellës.

-Kopje të licencës së vlefshme të subjektit furnizues,

Furnizuesi me të cilin operatori ekonomik ka lidhur nje kontratë furnizimi, në QKB si fushë të veprimtarisë ka: “Prodhim,tregtim me pakicë lulesh”, duke mos patur kështu lidhje me objektin e tenderit.

Gjithashtu nuk ka një licencë të vlefshme nga ana e furnizuesit pasi dokumenti i paraqitur është “Kërkesë për licencë” dhe jo Licencë e lëshuar nga autoriteti shtetëror përkatës edhe dhe një “Certifikate Origjine” e firmosur vetëm nga furnizuesi, e paverifikuar nga autoriteti shtetëror duke mos qenë kështu një dokument zyrtar që garanton origjinën.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: “Erdit Kalemi Kalemi”-PF me NIPT: L41306076P dhe Adresë: Tiranë,Pezë Helmes,pranë pikës së karburantit se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2,150,000(dy milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë)LEKË PA TVSH, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ndërmarrjes së Pasurisë Publike, Lagjja:“Gafurr Muco”,Lushnje, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të

përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO

Vendimi 450/2026, datë:01/04/2026.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ELSON ZEKA